| NJOFTIM PUNËSIMI | |
|---|---|
| **Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK** | Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura". Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë.<br>Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësoj për një vend pune: Elektro-Pompist Njësia Prodhimit Çermë pranë Drejtorisë Prodhimit dhe Transmetimit të Ujit nisur nga data më e afërt.Punëmarrësi i ri mban në gatishmëri dhe shfrytëzon sipas rregullave të teknikës stacionin e pompimit. |
| **Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:** | • Merr dhe dorëzon turnin duke shënuar në formatin e caktuar nga Shoqëria në librin e shënimeve, problemet e konstatuara gjatë turnit.<br>• Për stacionet me elektricist, lëshimi i pompave bëhet në bashkëpunim midis pompistit dhe elektricistit. Për Stacionet pa elektricist, pompisti manovron vetë për vënien në punë të elektro-pompave bazuar në rregulloren teknike.<br>• Mban lidhje me Përgjegjësin e Turnit për probleme që dalin gjate turnit.<br>• Nuk largohet nga turni pa i ardhur ndërruesi.<br>• Merr pjesë në remontet e kryera nga grupi i remonteve mekanike.<br>• Plotëson rregullisht librin e shfrytëzimit të Stacionit, sipas formatit të caktuar nga Shoqëria<br>• Zbaton me përpikëri Rregulloren e Sigurimit Teknik në punë. Çdo vit del para komisionit të sigurimit teknik për t'u pajisur ose rifreskuar dëshminë përkatëse. Në të kundërt i hiqet e drejta për të punuar në shfrytëzimin e elektro-pompave si pompist. |

| | |
|---|---|
| | • Ka për detyrë të pajiset me librezën e shëndetësisë sipas rregullave në fuqi, dhe nuk lejohet të kryejë shërbimin në stacion nëse nuk e ka plotësuar atë periodikisht.<br><br>• Bën shërbimin ndaj pompave (ndërron litarët e pompave, kryen grasatimin e kushinetave, karikimin e pompës përpara lëshimit, dhe çdo veprim tjetër sipas normave dhe rregulloreve të miratuara), mbasi është siguruar që i ka stakuar ato nga rrjeti elektrik.<br><br>• Nxjerr jashtë pune puset nga të cilët konstatohet së uji vjen me ndotje (i turbullt, etj.) në bashkëpunim me klorinuesin dhe njofton menjëherë Përgjegjësin e Turnit.<br><br>• Administron dhe mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për inventarin e makinerive dhe pajisjeve që ka në përdorim stacioni i pompimit |
| **Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:** | • Eksperienca pune të mëparshme.<br>• Librezë e Punës<br>• Certifikatë Familjare<br>• Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës<br>• Dy fotografi<br>• Fotokopje e Dëftesës me listën e notave e noterizuar<br>• Dëshmi Penaliteti<br>• Raporti Mjekësor<br>• Vërtetim Vendbanimi |
| **Kushtet e punës:** | • Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur.<br>• Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani. |
| • Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 29.06.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar. | |